

VENDIM
Nr. 112, datë 10.6.2024

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s PËR
KËRKESËN E SHOQËRISË “5GX ENERGY” SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3 e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.6.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 866/4 prot., datë 7.6.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë ‘5GX Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “5GX Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 855 prot., datë 3.4.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 63, datë 12.4.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- Me shkresën me nr. 867/3 prot., datë 22.4.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo plotësuar pjesërisht.

- Gjithashtu me shkresën nr. 1030 prot., datë 2.5.2024 ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mbi fillimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie.

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit plotësues të depozituar nga shoqëria, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 91, datë 13.5.2024, vendosi zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me aplikimin e shoqërisë “5GX Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me qëllim zhvillimin e korrespondencës së mëtejshme apo dhe planifikimin e një seance dëgjimore për të sqaruar dokumentacionin që ka mbetur ende për t’u plotësuar dhe depozitimin e tij në vijim në ERE.

- Me shkresën nr. 867/7 prot., datë 20.5.2023 dhe e-mail-in njoftues protokolluar më pas në ERE me nr. 867/8 prot., datë 28.5.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar zhvillimin e një seance dëgjimore, për plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të plotësuar pjesërisht prej saj.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 867/9 prot., datë 30.5.2023 dhe nr. 867/11 prot., datë 4.6.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit i cili ka nevojë për sqarime të mëtejshme.

- Në këto kushte dhe në mbështetje të përcaktimeve të nenit 14, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, dhe nenit 67 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, vlerësohet zgjatja deri në 30 (tridhjetë) ditë e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “5GX Energy” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me qëllim vlerësimin/sqarimin e dokumentacionit të depozituar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit mbi kërkesën e shoqërinë “5GX Energy” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 10 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “5GX Energy” sh.p.k. mbi vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti